Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve për zhvillim rajonal, projektu ISD organizoi dy vizita studimore në vitin 2011, për nënpunës publikë të nivelit qendror dhe lokal, me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe përvojës lidhur me çështjet e zhvillimit rajonal dhe fondet europiane në këtë sektor. Vizitat në Irlandë, Irlandën e Veriut, Maqedoni dhe Bullgari u dhanë mundësinë pjesëmarrësve, zyrtarë të lartë qeveritarë dhe aktorë kryesorë rajonalë të njiheshin më nga afér me sitemet dhe mekanizmat financiarë të BE-së.

-Kuadri politik i zhvillimit rajonal

Rishikimi i paketës së reformës së Fondit të Zhvillimit të Rajoneve ka vijuar gjatë gjithë vitiit dhe është në proces konsultimi me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (sekretariati teknik për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve). Në maj 2011, DEBASKON-it iu paraqit një koncept i ri strategjik për zhvillimin rajonal në vend, krahas procesit të rishikimit të strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim.

-Progresi në lidhje me përgatitjet e Shqipërisë për IPA III (Zhvilim Rajonal) dhe Kuadrin e Koherencës Strategjike dhe Programit Operacional

Projekti ISD ka mbështetur Ministrinë e Integrimit European dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit (si strukturën operative për IPA III) nëpërmjet procesit të përgatitjes së Kuadrit të Koherencës Strategjike (2011-2013) dhe programit operacional. Ky i fundit mbulon sektorët e transportit, e mjedisit dhe të konkurrueshmërisë rajonale.

Planifikimi i territorit



Më 23 Prill, 2009, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin nr. 10119 "Për Planifikimin e Territorit", i amenduar. Miratimi i Ligjit u pasua nga 7 akte nënligjore dhe të paktën 1-2 të tjera që priten të dalin së shpejti. Ligji hyri plotësisht në fuqi më 30 shtator 2011. Në 9 muajt që vijuan, nga Shtatori 2011, zhvillimet në lidhje me zbatimin e ligjit kanë qënë të pakta. Arsyja për këtë lidhet me ndryshimet që janë midis kornizës ligjore ekzistuese të planifikimit dhe kornizës së re, si dhe aftësisë që kanë institucionet dhe zhvilluesit për t'iu përshtatur këtyre ndryshimeve. Përgjithësisht, ligji për planifikimin e territorit është më kompleks dhe i tejkalon në mënyrë të konsiderueshme kapacitetet aktuale zbatuese të zyrtarëve publikë. Sfidat e zbatimit të ligjit nënvisojnë shpeshherë nevojën për një rishikim të tij. Në fakt, nga shtatori 2011, janë kryer dy rishikime të akteve nënligjore, të cilat trajtojnë disa çështje specifike, por nuk garantojnë konsistencë me të gjithë kornizën ligjore. Në këto kushte, do të ishte e rekomandueshme të fillonte zbatimi i ligjit me temp të plotë, sesa të kryheshin ndryshime i një numri parashikimesh në ligj, pa u njojur ende ndikimi i tyre. Ministritë kanë një rol më të madh në planifikimin e territorit pasi nuk kufizohen thjesht me komente/diskutime të planeve territoriale bashkiakë; ato duhet të përgatisin plane territorialë sektorialë si dhe të propozojnë zona të rëndësishë kombëtare. Të dyja instrumentet kanë rëndësi dhe ndikim të konsiderueshëm në planifikim vendor. Në disa raste, vërehet një ambiguitet në ndërveprimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKTP) dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) sipas ligjit AKPT-ja varet nga Këshilli i Ministrave (KM). Ndërsa bazuar në një akt nënligjor, AKPT-ja ka buxhetin dhe strukturën e saj, që miratohet nga MPPT-ja. Bashkitë e Komunat kanë një numër kompetencash në planifikim urban, ndërkohë që planifikimi i territorit përbën një kompetencë të ndarë në nivel vendor e kombëtar. Përgjegjësitë e qarkut në planifikim dhe zhvillim të tokës mbeten ende të paqarta. Zhvilluesit janë disi hezitues ndaj ligjit të ri, për shkak të disa ndryshimeve në terminologji e praktika lejesh. Këto ndryshime nuk janë në kurriz të zhvilluesve, por kërkojnë që ato t'i përshtaten këtij sistemi të ri. Nga ana tjetër, ligji i ri ofron një numër instrumentesh krijuese për zhvillimin e tokës, të cilat mund të përdoren me efikasitet nga zhvilluesit. Si pjesë e kësaj, pronarët e tokave gjëzojnë më shumë të drejta për mbrojtje të pronës së tyre, por nga ana tjetër duhet të kuptojnë që e drejta për pronë nuk njësohet me të drejtën për të zhvilluar. Ndaj procesi i planifikimit dhe i zhvillimit duhet bazuar në këto aspekte të rëndësishme.

Takime konsultative

Për një zbatim sa më efektiv të ligjit nr. 10119 "Për Planifikimin e Territorit", Co-PLAN asistoi Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), me mbështetjen e Bankës Botërore, në organizimin e gjashtë takimeve konsultative me përfaqësues të bashkive, komunave dhe qarqeve të të gjithë vendit, për të diskutuar hartimin e "Manualit Teknik" dhe "Udhëzuesit për Qytetarin". Takimet, të cilat u zhvilluan gjatë periudhës tetor-nëntor 2011, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Fier, ftuan në diskutim autoritete të planifikimit urban në një diskutim të drafteve të manualit teknik, i cili ka për qëllim të ndihmojë institucionet qeverisëse në nivel qendror dhe vendor në zbatimin e ligjit të ri të planifikimit të territorit dhe instrumentet përkatëse. Pjesëmarrësit patën mundësi të ngrenë pyetje në lidhje me procedurat e zbatimit, përshtatjet në nivel organizimi institucional dhe ofruan raste nga praktika e tyre e punës.

Gjatë takimeve u prezantua gjithashtu dhe manuali i dytë, "Udhëzuesi për Qytetarin", i cili në ndryshim nga "Manuali Teknik", është i strukturuar në formën e pyetje-përgjigjeve dhe ka për qëllim t'u vijë në ndihmë qytetarëve me nacionet, pyetje, dhe proceset bazë të ligjit të ri.



PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I TERRITORIT NË SHQIPËRI

Manuali Teknik/Planifikimi/dhë Kontroll/ë Zhvillimi/ për vendim/marrësit, profesionistë, dhe zhvilluesit



Transformimet urbane ballkanike

A mund të përdoren dhe të aplikohen njohuritë nga procesi i transformimit urban ballkanik brenda kontekstit holandez, tani që zhvillimi organik tokës është duke u aplikuar në Holandë?

Kjo pyetje ishte në qendër të një takimi ndërkombëtar në Holandë, ku dy nga themeluesit e Co-PLAN - Dritan Shutina dhe Besnik Aliaj - u ftuan të marin pjesë për të prezantuar eksperiencën urbane shqiptare në kontekstin holandez. Për të lehtësuar kontekstualizimin e eksperiencës balkanike në çështje te transformimeve urbane, diskutimi u përqendrua në aspektet e kulturës së planifikimit holandez.

Një pjesë e rëndësishme e debatit iu dedikua lojës "Play the City", nga Ekim Tan, në të cilën qytetarët, dhe grupet e interesit në nivel lokal, duhet të bashkëpunonin për "dizenjimin" e ambientit të tyre urban për rastin e Haagse Binckhorst, Holandë. Ky takim u organizua nga ekspertë, artistë, arkitektë dhe dizajnër holandezë.




Njohuribërja dhe ndikimi në politikëbërje



Rënia e regjimit komunist në Shqipëri në vitin 1991, krahas ndryshimeve të tjera të dukshme, shënoi fundin e një sistemi të centralizuar, i cili karakterizohej nga një kulturë kolektiviste. Kaq shumë sa vitet 90' përbënин një pikëpyetje të madhe për shoqërinë shqiptare, në lidhje me identitetin dhe ndryshimet socio-politike të cilave po u nënshtrohej. Ndryshimet e pakontrolluara demografike rezultuan në transformime të shpejta dhe kaotike të qyteteve, që çuan në lindjen e qytetit të nevojave.

Nevoja për burime njerëzore të kualifikuara me njohurinë dhe ekspertizën e duhur në planifikim dhe arkitekturë është një çështje problematike e njohur dhe e trajtuar nga Co-PLAN që në fillimet e tij; nëpërmjet projekteve, publikimeve, trainimeve, seminarëve, tryezave, forumeve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me mediat, vazhdimesh jemi përpjekur për rritje në nivelin e ndërgjegjësimit publik, dhe për përmirësim të edukimit

qytetar në çështje të qytetbërjes. Aktiviteti i Co-PLAN në fushën e njohuri-bërjes fitoi një dimension të ri në vitin 2006, pas sinergjisë me Universitetin POLIS, Shkollën Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave Urbane të Zhvillimit. Ky dimension është forcuar më tej me mbështetjen e vazhdueshme institucionale të *Think Tank Fund – Open Society Institute (Budapest)* prej viti 2008. Sot ato kontribuojnë në ndërtimin e një mase të re në fushën e zhvillimit urban nëpërmjet edukimit dhe inkurajimit për një ndërgjegjësim më të madh të publikut nëpërmjet iniciativave të vazhdueshme, si forumet e hapura, publikime, konferenca, seminare etj. Megjithatë, një pjesë e mirë e publikut nuk i njohin dhe nuk i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, duke shkaktuar një vakuum ndërgjegjësimi. Nëpërmjet ekspertizës profesionale dhe advokimit, ne mund të bëjmë ndryshime duke sfiduar status quo-në aktuale.



Gjithashtu ne mund të ndryshojmë mendësinë në nivel opinioni publik nëpërmjet publikimeve, të cilat do të mundësonin publikun/komunitetin të njiheshin me të drejtat e tyre bazike dhe të ekspozoheshin ndaj një mendësie të ndryshme, ku për zhvillimin e një qyteti mundësish, do të ishte e nevojshme të ndryshonte sjellja individualiste kundrejt një qasjeje më kolektive e gjithëpërfshirëse.

Njëkohësisht, edhe një ndryshim në nivel politikëbërjeje; me qytetarë më të sensibilizuar mbi të drejtat e tyre, lind nevoja për politikëbërje më të përgjegjshme dhe transparente. Si qytetarët, ashtu dhe politikëbërësit duhet të përshtasin një mendësi të re në mënyrën se si ata i vlerësojnë dhe i përdorin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në një sistem demokratik.

Qytetbërja dhe problemet e transformimit nuk duhet të shërbejnë si sencacione dhe instrumenta të tillë gjatëtave elektorale.


gjatë fushatave elektorale.

Në Co-PLAN, ne mendojmë që ndryshimet në mendësi dhe sisteme vlerash kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse e të vazhdueshme. Për këtë arsyе në Co-PLAN ne i japim rëndësi të veçantë njojurisë, ndarjes së saj me publikun dhe ekspertë për të ndikuar në një politikëbërje më të mirë.

Në funksion të promovimit të ndarjes së njourive, Co-PLAN dhe U_POLIS kanë ndërmarrë organizimin e një aktiviteti me përmasa ndërkombëtare 'Javët e Arkitekturës në Tiranë' (JAT), në tetor 2012. JAT do të bashkojë një numër partnerësh, përfshirë Bashkinë e Tiranës, për një shkëmbim ndërkombëtar të njourive ndërmjet profesionistëve, dhe një forcim të interesit të publikut në arkitekturë, art dhe dizajn, si disiplina thellësisht të ndërlidhura me zhvillimin e një qyteti bashkëkohor.

Rilindja e shesheve të qyteteve ballkanike

Mënyra se si i shohim ne sheshet e qytetit në Ballkan sot, sigurisht përbën interes për të kuptuar se sa roli i tyre ka ndryshuar me kohën. Sot, sheshet e qytetit përdoren në mënyra shumë të ndryshme nga komunitetet e tyre, të cilat në vetvete gjenerojnë lloje të ndryshme energjish, njësoj ndikuese. Duke u bazuar mbi këtë, projekt "Rilindja e shesheve të qyteteve ballkanike" synon të kontribuojë në ringjalljen e shesheve të qytetit, si vende të mundshme publike që nxisin identitetin kulturor dhe për të promovuar diversitetin nëpërmjet zbatimit të politikave publike dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit. Ai gjithashtu kërkon të sjellë njerëzit me ide të ndryshme në një proces përfshirës, që prodhon rekomandime të realizueshëm me ndikime të rëndësishme. Me anë të seminareve, workshop-eve dhe pyetësorëve, Co-Plan është përpjekur të promovojë dhe të shkëmbejë praktika se si sheshet e qytetit mund të transformohen në hapësira të gjalla, krijuese dhe të jetueshme nëpërmjet performancave në hapësirat publike në qytetet e Durrësit dhe Tiranës. Me anë të tyre, shpresohet të ndikohen qeveritë vendore, profesionistët dhe qytetarët të punojnë së bashku dhe të marrin përgjegjësinë e duhur në transformimin e shesheve. Gjithashtu, pritet që autoritetet vendore, të pajisen me dije që do t'i mundësojë ata të marrin vendime praktike për të stimuluar transformimin e shesheve në qytetet e tyre. Në një nivel më të gjerë kombëtar pritet që rezultatet e aktiviteteve mund të ndikojnë në nivelin e hartimit të politikave përmes aplikimit praktik të udhëzimeve dhe përdorimit të veprave të artit.



Vizitë studimore në Barcelonë

Co-PLAN ka pranuar me kohë rëndësinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL) në përmirësimin e mërë që nis në nivelin lokal dhe rritjen e avantazhit konkurruesh të një njësie të qeverisjes vendore. Përmes përvojave të mëparshme dhe projekteve aktuale, Co-PLAN po punon për të sjellë së bashku zyrtarët e qeverisjes vendore, sektorët privat, joftimprurës dhe komunitetin lokal, për të punuar së bashku drejt një rritjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Për këtë qëllim, në tetor të vitit 2011, Co-PLAN organizoi një udhëtim studimor në Barcelonë për përfaqësues të qeverisë qendrore dhe vendore për t'u njojur me praktikat qëverisëse të një prej shembujve më të suksesshëm të zhvillimit ekonomik në botë, Barcelona. Për më tepër, udhëtimi studimor, i projektuar në bashkëpunim me organizatën "Cluster Development", Barcelonë, shërbeu si një mundësi për zyrtarët shqiptarë për të marrë në konsideratë partneritetet lokale dhe perspektivat për bashkëpunime të mundshme në të ardhmen me Bashkinë e Barcelonës.




Diplomimi i kursantëve të I-rë pasuniversitarë në planifikim hapësinor

Janë akorduar diplomat e para të kurseve pasuniversitare në planifikimin hapësinor, si pjesë e programit Master Profesional, organizuar nga Co-PLAN, Institut i Zhvillimit e Habitatis, në bashkëpunim me IHS/Erasmus University, Holandë dhe Universitetin POLIS. Më 19 nëntor 2011, 36 diplomantët e viti të parë të këtij programi janë nderuar në një ceremoni përmbyllëse të organizuar në mjediset e Universitetit POLIS.

Diplomantët u përvendosën nga Ambasadori i Holandës, Z. Henk van den Dool dhe Z. Jan Franzen, zëvëndësdrejtor i Institutit Hollandez IHS, në shenjë të bashkëpunimit të ngushtë në kuadër të programit MATRA, IHS/Erasmus dhe Co-PLAN/U_POLIS. Kurset pasuniversitare mbështeten nga Programi MATRA për Transformimin Social për Shqipërinë, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës. Kurset pasuniversitare në fushën e planifikimit hapësinor përqendrohen në çështje të planifikimit hapësinor të qendrueshmë, zhvillimit dhe manaxhimit të tokës dhe instrumenteve monitoruese, si dhe teori të zhvillimit urban për qytete gjithëpërfshirëse. Këto kurse shërbejnë si platformë për ngritjen e kapaciteteve në planifikim hapësinor në Shqipëri, në zbatim të ligjit "Për Planifikimin e Territorit", datë 23.04.2009 nr. 10119 dhe akteve nënligjore përkatëse. Pjesëmarrësit në kurse, të cilët vijnë nga sektori publik dhe privat, si dhe nga organizata të shoqërisë civile, janë pajisur edhe me njohuri të planifikimit në përputhje me politikën e udhëzimet e BE-së. Në të njëtin kohë, Universiteti POLIS dhe Erasmus University/IHS inauguroan fillimin e programit të përbashkët Master Profesional në "Planifikim dhe Manazhim Urban".





Një miliard akte të gjelbërta

“Dita e Tokës - një miliard akte të gjelbërta”, u mbajt në ambientet e reja të U_POLIS, në bashkëpunim me Lëvizjen BELLS / Instituti i Kërkimeve Urbane, dhe me U_POLIS, më 26 prill 2011. Ngjarja priti personalitetë të shqar dhe ekspertë, veçanërisht të fushës së mjedisit, të cilët ndanë një numër prezantimesh mbi çështjet e eficiencës së energjisë dhe burimeve alternative të energjisë në Shqipëri.

Konferenca AESOP

Shoqata e Shkollave Europiane të Planifikimit - AESOP Konferenca për shkëmbim njojurish në planifikim: fushë kërkimore, lëvizje, kreativitet inovacion.Organizimi i kësaj konference në Tiranë përbën një arritje të madhe, duke mirëpritur drejtuesit e shkollave të planifikimit nga një rrjet prej më shumë se 120 universitete dhe institucionet akademike të specializuara në këtë fushë nga e gjithë Europa. Konferenca u përvendoset nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Prof. Myqerem Tafaj. Konferenca, gjatë së cilës u mbajtën prezantime, seminare dhe vizita studimore, zgjati katër ditë. Konferenca e gjashtë Europiane e këtij rrjeti mbarakademik dhe profesional, në kuadër të GPEAN: Edukimi Global i Planifikimit, Shoqatat e Rrjetit u konsideruan si të suksesshme nga të gjithë pjesëmarrësit dhe Presidentja e AESOP-it, znj. Kristina Nilsson.



[3]

PROJEKTE

projects projekte projecten proyectos progetti projets 2011

- Punë kërkimore e aplikuar - Ndikimi në politikëbërje (Faza 2)
- Promovimi i partneriteteve për qytete të mundësive të përbashkëta
- Mbështetje teknike për zbatimin e ligjit të ri për planifikimin e territorit dhe rregulloreve
- Program Buxhetimi Afatmesëm transparent dhe profesional për qeverisjen vendore në Shqipëri - 2
- Planifikimi strategjik, buxhetimi, manaxhim i financiar dhe performanca fiskale
- Përmirësimi i manaxhimit të mbetjeve në NJQV-të partnere të dldp në rajonet e Shkodër - Lezhë
- Huamarrja e qeverisjes vendore: sfida e NJQV-ve dhe zhvillimi ekonomik lokal
- Rrjeti i informacionit për qeveritë vendore

Punë kërkimore e aplikuar për politika publike – Ndikimi i politikëbërjes

Periudha e zbatimit: dhjetor 2010 - 2011

Donatori: Institut i Shoqërisë së Hapur, Budapest

Fondi: 71, 851 USD

Zbatuar në: Shqipëri

Viti 2011 shënoi fillimin e fazës së dytë të programit ‘Ndikimi në politikëbërje’ për Co-PLAN. Në mënyrë të ngjashme me fazën I, faza e II-të e punës për “Ndikimin në politikëbërje” do të mbështetet nga ‘Think Tank Fund’ i OSI, Budapest, për një periudhë 3-vjeçare (2011-2013). Në thelb të qëllimit të programit është fuqizimi dhe konsolidimi i Co-PLAN si një Institut Kërkimor Politikash i suksesshëm dhe i respektuar në fushat e tij të ekspertizës, duke kontribuar në shoqerinë shqiptare nëpërmjet forcimit të politikëbërjes dhe të kontributit në arsimimin e lartë në Shqipëri. Në këtë drejtim, objektivat e përgjithshme të programit janë: 1) hartimi dhe organizimi në koleksione i produkteve politike; 2) hartimi dhe zbatimi i strategjive efikase të advokimit në lidhje me produktet e politikave; 3) përmirësimi i kuadrit institucional dhe organizativ i Co-PLAN në përshtatje me qasjen dhe misionin e tij (asistencë teknike, zgjerimi potencial rajonal, në bashkëpunim me Universitetin POLIS, ndikimi në politikëbërje). Arrijet e viti 2011, për secilën nga objektivat, janë të shprehura në formën e treguesve.

Njohuribërja

Hartimi dhe organizimi në koleksione i produkteve politike.

Objektivi 1

1. Punë hulumtuese dhe hartuese për publikimin e rreth gjashtë dokumenteve politike në 2011-ën, përkatësisht në:
 - a. “Transfertat ndërqeveritare” përgatitur dhe shpërndarë gjatë muajit shkurt 2011.
 - b. “Mbetje urbane” përgatitur në muajin qershori 2011.
 - c. Dy manualë planifikimi dhe zhvillimi të tokës: “Manuali Teknik” dhe “Udhëzuesi për Qytetarët”.
 - d. Buxhetimi Afatmesëm dhe instrumentët financiarë.
 - e. Sistemi i planifikimit në Shqipëri sipas kërkësave dhe orientimeve të BE-së.
 - f. Një raport vlerësues mbi gjendjen e huamarrjes vendore në Shqipëri.
2. Përfunduan eksperditat e planifikimit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011.



BRETH CO-PLAN

EKSPERTIZA

PROJEKTE

PARTNERET

PROSPEKT PLINESIMI


DIP

ENGLISH

SEARCH...



project **grid**



Për ku jemi
nisur kështu?



www.co-plan.org

PROJECT PORTFOLIO



Co-PLAN GAZETTE

Publikim Gjashtrimujor i Co-PLAN - Instituti për Zhvillimin e Habitati

Gazeta Nr. 3 - Oenshor 2012

Publikum-Gaststätten

Gazeta Nr. 3 - Oenshor 2012

A photograph showing a woman in a red shirt and black shorts standing next to a white display board. Another person is sitting on the floor nearby. The display board has some text and images on it.

Java e Arkitekturës në Tiranë: 8

Stacioni me Shishe Plastike: 2

Diskuto hapēsirēn tēnde: 16

Baş te değiştiret zeri yit 14

Planifikimit të Territorit në Shqipëri

Ndikimi në politikëbërje

Hartimi dhe zbatimi i strategjive efikase të advokimit në lidhje me produktet e politikave.

Objektivi 2

1. U hartua plani operacional për strategjinë e advokimit për vitin 2012.
2. U përgatitën dhe u shpërndanë dy numrat e parë të Co-PLAN GAZETTE përkatësisht në qershor dhe dhjetor 2011.
3. Përfundoi ridizenjimi i faqes zyrtare të Co-PLAN, e cila përditësohet rregullisht.
4. U realizuan katër tryeza të rrumbullakëta, përkatësisht në transfertat ndërreveritare, eficiencën e energjisë në strehim, huamarrjen e qeverisë vendore, dhe zhvillimin rajonal – roli i qarkut në decentralizim dhe rajonalizimi i Shqipërisë u organizua nga IDM dhe Co-PLAN në nëntor 2011.
5. U organizuan katër tryeza mbi planifikimin në bashkëpunim me AKPT-në, si pjesë e procesit të konsultimit për manualet e planifikimit. Tryezat u organizuan në titor me pjesëmarrje që varionte nga 50-170 persona.
6. Trajnime mbi buxhetimin afatmesëm dhe manaxhimin e integruar të mbetjeve urbane u finalizuan.
7. U zhvilluan gjashtë performanca në sheshe publike të qyteteve të Durrësit dhe Tiranës.
8. Debate ndërkombëtare “on-tour” në Ballkanin Perëndimor u organizua si pjesë e ‘Kulturës së re të Planifikimit Hapësinor’ në bashkëpunim me NAI, Holandë dhe U_POLIS.
9. Konferanca e gjashtë e AESOP me temën “Shkëmbimi i njohurive në planifikim: punë kërkimore, mobilitet, krijimtari dhe inovacion”, ku Co-PLAN dha kontribut të rëndësishëm.
10. U organizua Konferenca e Ditës së Tokës mbi çështje të zhvillimit të qendrueshëm në Shqipëri, në bashkëpunim me U_POLIS.
11. U zhvillua forumi mjedisor mbi politikat e BE-së mbi zhvillimin e qendrueshëm në zbatimin e acquis veçanërisht në fushën e mjedisit me fokus në energji e transport.
12. U promovuan botimet: “Politikëndjekës apo Politikëbërës!” dhe “Forumi A+P 7”
13. Co-PLAN bëri të mundur organizimin e pesë tryezave rajonale mbi manaxhimin e mbetjeve.

Zhvillimi organizativ e institucional

Përmirësimi i kuadrit institucional dhe organizativ të Co-PLAN në përshtatje me qasjen dhe misionin e Co -PLAN (asistencë teknike, zgjerimi potencial rajonal, në bashkëpunim me Universitetin POLIS, ndikimi në politikëbërje).

Objktivi 3

1. U ngrit Njësia e Punës Kërkimore dhe Advokimit, me gjashtë ekspertë në komunikim, punë kërkimore dhe advokim.
2. Një plan strategjik afatmesëm u përgatit në shkurt të vitit 2011 pas një seminari njëjavor të brendshëm të stafit në hartimin e politikave dhe advokimit. Misioni i Co-PLAN u rishikua tërësisht; ndryshime ndodhën dhe në aspektin e burimeve njerëzore.
3. Më shumë se 50 tituj publikimesh të reja me interes iu shtuan bibliotekës së Co-PLAN.
4. Pjesëmarrja në një simpozium ndërkombëtar mbi mbetjet e ngurta e një eksperti të Co-PLAN i cili prezantoi dokumentin për administrimin e mbeturinave të ngurta në Shqipëri. Simpozumi ndërkombëtar u zhvillua në Sicili, Itali, në shtator të vitit 2011.

Promovimi i partneriteteve për qytete të mundësive të përbashkëta

Periudha e zbatimit: maj 2010 - prill 2013

Donatori: Qeveria Holandeze nëpërmjet programit MATRA

Fondi: 174, 652 EUR

Zbatuar në: Fier, Durrës, Shkodër, Tiranë

“Promovimi i partneriteteve për qytetetë të mundësive të përbashkëta – Ngritura e kapaciteteve për planifikimin territorial gjithëpërfshirës” hyri në vitin e tij të dytë të zbatimit. Ky projekt mbështetet nga qeveria holandeze nëpërmjet programit MATRA në Shqipëri. Projekti po zbatohet në bashkëpunim me IHS - Institut i për Strehimin dhe Zhvillimin Urban të Roterdamit (Holandë), Universitetin Polis, Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike (në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit), shoqatat e njësive vendore dhe bashkitë e Shkodrës, Durrësit dhe Fierit. Qëllimi i projektit mund të përmblidhet:

1) të promovojë planifikimin me pjesëmarrje ne nivel lagje në bashkitë e Fierit, Durrësit dhe Shkodrës, duke harmonizuar interesat publike dhe private për zhvillimin hapësinor. 2) të zhvillojë një platformë për ngritjen e kapaciteteve dhe të sigurojë shpërndarjen e njohurive në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor që synojnë zyrtarët e qeverisë dhe profesionistëve; 3) të ngrejë koalicionet e sektorit publik dhe shoqërisë civile për të formuluar rekomandime të politikës dhe për të zhvilluar instrumentet e implementimit për zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm hapësinor.

Objektivi 1

Zhvillim me pjesëmarrje

Të promovojë planifikimin me pjesëmarrje ne nivel lagje në bashkitë e Fierit, Durrësit dhe Shkodrës, duke harmonizuar interesat publike dhe private për zhvillimin hapësinor.

1. Kryerja e vlerësimit të nevojave për shtatë zona gjeografike, në: Fier, Durrës dhe Shkodër.
2. U krijuan koalicione lokale dhe planet për shtatë lagje në Fier, Durrës dhe Shkodër, duke përfshirë zgjedhjen e manaxhimit të tokës inovative dhe instrumentet e kontrollit të zhvillimit.
3. Ndërtim kapacitetesh për qeveritë vendore, OJQ-të dhe profesionistë të zhvillimit urban.

4. U hartuan dhe u përgatitën udhëzimet për zbatimin e rregullores së manaxhimit të tokës dhe kontrollit të zhvillimit në Fier, Durrës dhe Shkodër.
5. U organizua një konsultim për zbatimin e udhëzimeve me aktorët kryesorë (sektori publik, sektori privat dhe civil shoqëri) në Fier, Durrës dhe komunat Shkodër.



Ngritje kapacitetesh

Të zhvillojë një platformë për ngritjen e kapaciteteve dhe të sigurojë shpërndarjen e njohurive në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor që synojnë zyrtarët e qeverisë dhe profesionistëve.

Të ngrejë koalicionë të sektorit publik dhe shoqërisë civile për të formuluar rekomandime të politikës dhe për të zhvilluar instrumentet e implementimit për zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm hapësinor.

Objektivat 2+3

1. Praktikat hapësinore të zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm u shpërndanë në katër platforma web.
2. U organizuan gjashtë seminare rajonale (për sektorin publik dhe organizatat e shoqërisë civile brenda Shqipërisë), në manaxhimin e tokës dhe instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit.
3. Artikuj mbi praktika hapësinore të zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm u botuan në media të ndryshme.
4. U organizua një program pasuniversitar i përbërë nga 5 module të trajnimit: 1) qytetet përfshirëse; 2) instrumente të veçanta të manaxhimit të tokës dhe të kontrollit të zhvillimit; 3) planifikimi për zhvillimin e qëndrueshëm; 4) direktivat e BE-së për planifikimin hapësinor; 5) dhe ofrimi i shërbimeve publike.
5. U organizua një vizitë studimore në Poloni për të mësuar nga praktikat më të mira të një shteti të ri anëtar të BE-së.

Mbështetje teknike për zbatimin e ligjit të ri mbi planifikimin e territorit dhe akteve të tij nënligjore

Periudha e zbatimit: korrik - dhjetor 2011

Donatori: Banka Botërore

Fondi: 60, 000 USD

Zbatuar në: Shqipëri

Pas eksperiencës së suksesshme të mbështetjes teknike që Co-PLAN ofroi në përgatitjen e akteve nënligjore të ligjit të ri " Për Planifikimin e Territorit", të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave më 22 qershori 2011, Co-PLAN u angazhua në projektin 'Mbështetje Teknike për zbatimin e ligjit të ri mbi planifikimin e territorit dhe akteve të tij nënligjore. Nëpërmjet këtij projekti, Co-PLAN mbështeti Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit në zhvillimin e një baze të gjerë kuptimore dhe aplikimi të ligjit të planifikimit të territorit dhe akteve të tij nënligjore, duke zhvilluar dy manuale reference planifikimi urban/territorial për institucionet dhe qytetarët. Ky projekt u financua nga Banka Botërore dhe u zbatua gjatë periudhës 07/01/2011-12/30/2011.

Kjo mbështetje teknike mundësoi ofrimin e udhëzimeve dhe këshillave praktike për zyrtarë, autoritete të nivelit qendror dhe vendor, qytetarëve dhe sektorit privat. Në kuadër të projektit, u organizuan dhe takime konsultative me pjesëmarrje të gjerë nga pushteti qendror dhe vendor, grupe interesi, përfaqësues të shoqërisë civile, sektori privat si dhe komuniteti.

Në përfundim të projektit u publikuan dy manuale. "Manuali Teknik" i hartuar për t'u ardhur në ndihmë autoritetave në nivel qendror dhe vendor dhe institucioneve të përfshira në planifikimin e territorit, dhe "Udhëzuesi për Qytetarin" i cili u drejtohet qytetarëve dhe sektorit privat në një format më praktik.

Të dyja manualet shpjegojnë kornizën ligjore dhe rregullatore të zhvillimit urban në nivel qyteti, standarde të planifikimit urban, rregulla dhe udhëzime për projekte të madhësive të ndryshme, procedurat për aplikimin e lejeve për zhvillim, etj. Publikimi dhe shpërndarja e manualeve u shoqërua me një seri seminaresh trajnimi



Njohuribërje dhe ngritje kapacitetesh

Të sigurojë mbështetje për qeverinë në procesin e "kuptueshmërisë" dhe zbatimit të ligjit të ri "Për planifikimin e territorit", si dhe akteve nënligjore në nivel politikash.

Të ofrojë këshillim në çështje lidhur me zbatimin e këtij ligji, për zrytarë të qeverisë qendore, vendore, qytetarët dhe sektorin privat.

Të përfshijë grupet e interesit në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe OFJ-të, sektor privat, qytetarë etj., me anë të workshop-eve konsultuese, për të siguar që zëri i tyre do të dëgjohet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me zbatimin efektiv të ligjit.

Objektivat

1. U hartua në bashkëpunim më AKTP-në një "Manual Teknik" bazuar në diskutime me grupe të interesit. Manuali shërben për të lehtësuar të kuptuarit dhe aplikimin e ligjit të ri mbi planifikimin e territorit dhe rregulloret e saj, nëpërmjet shpjegimit të koncepteve përmes përdorimit të shembujve praktikë dhe teknikë.
2. U hartua një Udhëzues për Qytetarët në bashkëpunim me AKPT dhe bazuar në diskutime të hapura me qytetarë. Një Manual për Qytetarët i hulumtuar, i hartuar, diskutuar dhe me qytetarët. Ky udhëzues është konceptuar në formën e pyetje-përgjigje dhe synon të ndihmojë të gjithë qytetarët me nocionet, pyetje, dhe proceset sipas ligjit të ri për planifikimin territorial.
3. U organizuan një seri konsultimesh me përfaqësues të NJQV-ve nga i gjithë vendi për të diskutuar "Manualin Teknik", dhe mënyrën e përdorimit të tij.
4. U mbajtën tri takime konsultative qytetarë nga tri qytete të ndryshme, përkatësisht në Shkodër, Durrës, dhe Fier, për të prezantuar koncepte të rëndësishme nga ligji i ri.

Program buxhetimi afatmesëm transparent dhe profesional për qeverisjen vendore në Shqipëri - 2

Periudha e zbatimit: nëntor 2011 - 2012

Donatori: Institut i Shqipërisë e Hapur, Budapest

Fondi: 58,854 USD

Zbatuar në: Bashkia Berat, Fier, Lezhë dhe Korçë

Projekti "Program buxhetimi afatmesëm transparent dhe profesional për qeverisjen vendore në Shqipëri - faza II" filloj në nëntor 2011, pas përfundimit të fazës së I-rë. Ky projekt ndërton mbi përvojën e Co-PLAN në mbështetje të bashkive të Beratit, Fierit, Lezhës dhe Korçës për të zhvilluar PBA-në, e paralelisht duke bashkëpunuar me Ministrinë e Financave për të hartuar udhëzimet që ndihmojnë NJQVtë për të përgatitur programe buxhetimi afat-mesme të lidhura me dokumente zhvillimi strategjik. Kjo fazë e dytë bazohet në aktivitetet dhe në rezultatet e zhvilluara gjatë fazës së parë dhe të fokusohet në tri çështje kryesore: (i) përmirësimin e kapaciteteve të zyrtarëve qeveritarë lokale në lidhje me çështjet e manaxhimit financiar në përgjithësi dhe përgatitjen "Programit të Buxhetimit Afatmesëm" në veçanti, (ii) përmirësimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e PBA-së bazuar në tregues të quartë të performancës, dhe (iii) përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dytësor për përgatitjen PBA-së në nivel vendor në Shqipëri. Fokusi i aktiviteteve të Fazës së II-të është kryesisht në hartimin dhe në diskutimin e kurrikulave të trajnimit për zyrtarët e pushtetit vendor me shoqatat e qeverisjes vendore, përgatitjen e moduleve të trajnimit përanëtarët e këshillëve vendorë në lidhje me çështje të financave bashkiake, duke bashkëpunuar me MF për përgatitjen e udhëzimeve për pushtetin vendor se si të përgatiten PBA-të.

Objektivat
1+2

Ngritje kapacitetesh

Përmirësimi i kapaciteteve të zyrtarëve të qeverisjes lokale në lidhje me çështjet financiare të manaxhimit në përgatitjen e programit të përgjithshëm dhe PBA-së në veçanti.

Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e PBA-së bazuar në tregues të quartë të performancës.

U organizuan tri takime konsultative në çdo NjQV mbi përgatitjen e PBA-së.

U përgatitën dhe diskutuan me SHBSH-në, SHKSH-në e MF-në, pesë module trajnimi.

3. Struktura e programeve dhe e treguesit të monitorimit të dizajnuar në lidhje me objektivat strategjike të ZHEL-it, në komunat e Beratit, Shkodrës dhe Fierit.
4. Parashikimi financiar mbi të ardhurat vendore dhe shpenzimeve sipas strukturës së programit dhe shpenzimeve të përgatitur në përputhje me kërkesat e programit PBA në komunat e Shkodrës, Beratit dhe Fierit.
5. U përgatit një modul trajnimi për monitorimin dhe vlerësimin e PBA-së në nivel lokal për OSHC-të përgatitura në bazë të treguesve të performancës.

Objektivi 3

Ndikimi në politikëbërje

Përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dytësor për përgatitjen PBA-ve në nivel lokal në Shqipëri.

1. U organizuan dy seminare për konsultim dhe diskutim të udhëzimeve të PBA-ve për vitin 2012 në nivel lokal me MF dhe stafin teknik në nivel lokal përgjegjës për përgatitjen PBA-së.
2. Rekomandime në lidhje me përcaktimin e PBA-ve, numri i programeve buxhetore, si dhe organizimin e procesit në nivel NJQV-je për t'u pasqyruar në udhëzimin e MF-së për vitin 2012.

Planifikimi strategjik, buxhetimi, manaxhimi financiar dhe performanca fiskale

Periudha e zbatimit: korrik 2010 - dhjetor 2011

Donatori: InterCooperation Albania - dldp

Fondi: 99, 985 EUR

Zbatuar në: Rajonet Shkodër - Lezhë

Ky projekt bazohet në një numër aktivitetesh dhe produktesh të cilat jo vetëm rrisin kapacitetet e komunave dhe bashkive, por jepin një pasqyrë të qartë mbi manaxhimin financiar dhe instrumentet strategjike të zhvillimit në nivel lokal. Bazuar në këtë argument, programi qartësisht artikulon zbatimin e proceseve me pjesëmarrje jo vetëm në fazën përgatitore, por dhe përgjatë zbatimit dhe realizimit të produkteve përkatëse.

Ky projekt vjen në një kohë kur pjesa më e madhe e NJQV-ve sot përballen me sfidën e zhvendosjes nga përgatitja e planit strategjik tradicional ose të buxhetit vjetor, të cilat kryesisht raportojnë shifra, në një dokument shumë dimensional e të shtjelluar, që ndihmon për të artikuluar politikat lokale fiskale dhe financiare në lidhje me planet dhe programet strategjike dhe lehtëson komunikimin e tyre me audiencat e shumëlojshme.

Qëllimi i projektit është të përmirësojë financat urbane duke u përqendruar në përmirësimin e qeverisjes urbane përmes rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të NJQV-ve për manaxhimin financiar dhe fiskal.

Njohuribërja dhe ngritja e kapaciteteve

Të mbështeten NJQV-të në përmirësimin e strukturave të tyre qeverisëse, kapaciteteve dhe shërbimeve të caktuara publike në nivel vendor.

Fuqizimi i kapaciteteve të NJQV-ve në manaxhimin finaciar e fiskal, përfshirë buxhetimin afatmesëm dhe aktivitetet e tyre të përgjithshme.

Objektivat
1+2

1. U përgatit, publikua dhe shpërndra një Manual mbi "Planifikimin financiar strategjik afatmesëm e afatgjatë" në rajonet Shkodër - Lezhë.
2. U konsultuan dhe përgatiën pesë module trajnimi mbi manaxhimin financiar dhe PBA-në të lidhura me planin e zhvillimit strategjik.

3. U organizuan pesë kurse trajnimi në rajonet Shkodër-Lezhë për autoritetet vendore, ku u trajnuan një total prej 31 punonjësish, nga të cilët 14 ishin gra.
4. U asistuan katër NJQV me përgatitjen e PBA-së; nga të cilat dy u miratuan nga Këshilli Bashkiak dhe dy të tjera janë në proces miratimi.

Mbështetje teknike

1. 26 punonjësve nga katër NJQV iu ofrua asistencë e drejtpërdrejtë në punë (on the job assistance).
2. U asistua online komuna e Velipojës me përgatitjen e Paketës Fiskale 2012.
3. Instrumenti i Planifikimit Financiar u pilotua me sukses në bashkinë e Fushë-Arrëzit.
4. U realizua një bashkëpunim mes dy njësive vendore, përkatësisht mes komunës së Balldrenit dhe bashkisë së Vaut të Dejës.



Përmirësimi i manaxhimit të mbetjeve në NJQV-të partnerë të dldp në rajonet Shkodër - Lezhë

Periudha e zbatimit: korrik 2010 - dhjetor 2011

Donatori: InterCooperation Albania - dldp

Fondi: 50,000 EUR

Zbatuar në: Rajonet Shkodër - Lezhë

Gjatë vitit 2011, qeveria shqiptare miratoi dy dokumente të rëndësishme: Strategja Kombëtare e Mbetjeve (SKM), dhe Planin Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta (PKMMN). Këto zhvillime shërbjen për zbatimin e programit DLDP-II, ku Co-PLAN, Institut i Zhvillimin e Habitatit u angazhua në zbatimin e komponentit të Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta.

Qëllimi kryesor i programit është të forcojë kapacitetet e NJQV-ve në rajonin e Shkodrës dhe të Lezhës për një zhvillim të përmirësuar rajonal dhe reforma e decentralizimit në nivel kombëtar”.

Projekti kontribuon direkt në zbatimin e politikës kombëtare dhe ka dy rezultate veçanërisht të rëndësishme:

1. Përmirësimi i strukturave qeverisëse në bashkitë e komunat në rajonin Shkodër dhe Lezhë, si dhe të kapaciteteve dhe shërbimeve të caktuara publike: pastrimi dhe manaxhimi i mbetjeve.
2. Ndarja e praktikave të mira në nivel kombëtar nëpërmjet forcimit të shoqatave, duke ndikuar ligjin në politikëbërjen dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar.

Ngritje kapacitetesh dhe përmirësim i strukturave qeverisëse vendore

Përmirësimi i strukturave qeverisëse në bashkitë dhe komunat në rajonin Shkodër dhe Lezhë, si dhe të kapaciteteve dhe shërbimeve të caktuara publike: pastrimi dhe manaxhimi i mbetjeve.

Objektivi

1. Mbështetje e drejtpërdrejtë për komunën e Velipojës dhe bashkitë e Koplikut dhe Pukës me Planet e Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta. Autoritetet lokale kanë miratuar zyrtarisht planet vendore në Këshillet Bashkiakë.
2. Grupet e punës të ngritura në çdo NJQV u trajnuan dhe asistuan në përgatitjen dhe zbatimin e planeve, identifikimin e mangësive dhe përgatitjen e një plani veprimi afatmesëm për përmirësimin dhe modernizimin e manaxhimit të mbetjeve.

3. U zhvilluan dhe u përfunduan katër kurrikula trajnimi për përmirësimin e njohjes së procesit në nivel vendor.
4. U zhvilluan dhjetë trajnime në tetë bashki (Shkodër, Koplik, Rrëshen, Rubik, Pukë, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës) dhe nëntë komuna (Postribë, Shënkoll, Rrethina, Dajç - Lezhë, Zejmen, Milot, Velipojë, Oroshtë dhe Hajmel). Në të dyja rastet u trajnuan një total prej 36 punonjësish (20% e tyre ishin gra).
5. U zhvilluan tetë raste studimore në njësitë vendore nën mbështetjen e drejtëpërdrejtë të Co-PLAN.
6. U përgatit një manual udhëzues: "Mbi planifikimin e manaxhimit të mbetjeve të ngurta në nivel lokal" në gjuhën shqipe dhe angleze.



Huamarrja e qeverisjes vendore: sfida e NJQV-ve dhe zhvillimi ekonomik lokal

Periudha e zbatimit: korrik 2011 - gusht 2012

Donatori: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Fondi: 26,935 USD

Zbatuar në: Shqipëri

Gjatë vitit 2011, Co-PLAN ndërmori një projekt për të vlerësuar situatën në lidhje me huamarrjen vendore në Shqipëri. Me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri dhe në partneritet me MF, Co-PLAN po punon në analizimin e situatës për nga aspektet e: qëllimit të investimit, vlerësimit të ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik vendor dhe asistimin e njësive të qeverisjes vendore (nëpërmjet trajnimeve të stafit përgjegjës) për hartimin dhe përzgjedhjen në mënyrë eficiente të projekteve të finançuara nëpërmjet huasë/borxhit.

Analizë e përgjithshme

Të ofrojë një vlerësim të përgjithshëm të situatës në lidhje me qëllimin e përdorimit të huave të marra/të kërkua prej NJQV-ve dhe ndikimin e pritshëm të tyre në zhvillimin ekonomik vendor.

Të kontribuojë (së bashku me aktorë të tjera) në ngritjen e kapaciteteve të stafit të njësive të qeverisjes vendore në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me hartimin e studimeve të mundshmërisë dhe përgatitjen e projekteve pér të aplikuar pér kredi.

Të asistojë NJQV-të, në procesin e përgatitjes së projekteve të mundshme pér t'u finançuar nëpërmjet huasë, duke u përqendruar në studimin e mundshmërisë së investimit.

Objektivat

1. 28 intervista të realizuara me NJQV-të pér të identifikuar nevojat dhe qëllimin e përdorimit të huave të marra/kërkua.
2. Takime me përfaqësues të bankave dhe MF pér vlerësimin e mundësive pér të kredituar NJQV-në
3. Një tryezë diskutimi me NJQV-të, OSFA, bankat dhe donatorë të fushës pér prezantimin e raportit të vlerësimit dhe gjetjeve.
4. Struktura e kurrikulës së trajnimit pér 3 modulet e trajnimit u hartua dhe u konsultua.
5. Tri NJV të asistuara në vlerësimin e potencialit finanziar të tyre.

Rrjeti i informacionit për qeveritë vendore

Periudha e zbatimit: prill 2011 - dhjetor 2011

Donatori: Institut i Shoqërinë e Hapur, Budapest

Fondi: 10,000 USD

Zbatuar në: Shqipëri

Në vijim të një praktike të konsoliduar gjatë tri viteve të fundit, pasurimi i rregullt dhe përditësimi i librarisë elektronike LOGIN vazhdoi edhe përgjatë vitit 2011; janë shtuar 467 hyrje të reja lidhur me çështjet e qeverisjes vendore, përfshirë praktikat më të mira, zhvillimet e fundit, dokumentet e politikave, raportet studimore, materiale trajnuese dhe manualet për planifikimin urban, buxhetimin me pjesëmarrje, financat bashkiakë dhe mjedisin urban.

Bazuar në të dhënrat nga materialet e shkarkuara (ose të klikuara), në një total prej 28,637 artikujsh për vitin 2011, është bërë e qartë se NJQV-të e përdorin platformën si një burim për të përfshiruar materiale, veçanërisht për dokumente të natyrës procedurale dhe legjislative, si dhe studime të kryera mbi dokumentat e politikave në fushën urbane dhe rajonale, manaxhimin e finansave bashkiakë dhe të mjedisit urban.

Ndarje njojurish dhe ngritje kapacitetesh

Pasurimi i platformës LOGIN në tetë modulet e saj.

Zgjerimi i rrjetit të parnterëve për ndarjen e informacionit dhe të eksperiencave mbi reformën në administratën publike.

1. Një total prej 467 artikujsh të rindërtuar, në formën e dokumenteve, studimeve dhe materialeve legjislative janë shtuan librarisë; këto materiale ndahen në tetë kategori, lehtësishët të aksesueshme nga sitet e Co-PLAN (www.co-plan.org), U_POLIS (www.universitetipolis.edu.al).
2. Një total prej 28637 shkarkimesh janë regjistruar për periudhën prill – dhjetor 2011; 13714 shkarkime për periudhën Prill – Gusht 2011 dhe 14923 për periudhën gusht – dhjetor 2011.
3. Platforma u promovua në aktivitete të ndryshme të organizuara me përfaqësues të NJQV-ve, dhe një video instruktues mbi përdorimin e LOGIN u prodhua dhe u publikua në format elektronik.
4. Për të gjitha NJQV-të që nuk kanë mundësi të përdorin platformën elektronike online, u shpërndanë DVD me të gjitha materialet e postuara në LOGIN.

Objektivat



